

VENDIM
Nr.16, datë 15.6.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 24.12.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.32/17 Akti, që i përket:

KËRKUES: GENC LOCI, përfaqësuar nga avokat Jordan Daci, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.181, datë 9.4.2008, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1, 131/f e 134/g të Kushtetutës, neni 6/1 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe nenet 27, 28, 30 e 45 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vitore Tusha; përfaqësuesin e kërkuarit që u shpreh për pranimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuar, me vendimin nr.8, datë 23.1.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, është deklaruar fajtor dhe është dënuar me 5 vjet burgim për veprën penale të “prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Gjykata e Apelit Tiranë, mbi ankimin e tij, me vendimin nr.465, datë 26.5.2006 ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, pushimin e çështjes në ngarkim të kërkuarit dhe lirim të tij nga dhomat e paraburgimit.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e prokurorit, me vendimin nr.181, datë 9.4.2008, ka vendosur prishjen e vendimit nr.465, datë 26.5.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lëni në fuqi të vendimit nr.8, datë 23.1.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Kërkuar i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për cenim të procesit të rregullt ligjor në gjykimin penal.

Gjatë shpjegimeve në seancë gjyqësore kërkuar i ka kufizuar pretendimet, i ka vetëm në lidhje me gjykimin në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, duke parashtruar:

- Është cenuar e drejta për t'u mbrojtur, barazia e armëve, gjykimi kontradiktor dhe

rëndimi i pozitës së të pandehurit, pasi procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë është zhvilluar pa praninë e të gjykuarit dhe avokatit mbrojtës, në një kohë që gjykimi në këtë gjykatë është iniciuar me rekurs të prokurorit.

- Nga interpretimi i gabuar i nenit 283/1 të Kodit Penal, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë më ka dënuar për një veprim që nuk përbën vepër penale, duke cenuar të drejtën e mosdënimit pa ligj. Veç kësaj, kolegji ka cenuar parimin e *presumimit të pafajësisë*, pasi dyshimi nëse jam apo jo përdorues droge nuk është vlerësuar në favorin tim.

II

A. Mbi pretendimin se është cenuar e drejta për t'u mbrojtur dhe lidhur me të parimet e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit

Kërkuuesi ka pretenduar se gjykimi i inicuar nga rekursi i prokurorit dhe i zhvilluar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në mungesë të tij dhe të mbrojtësit ka cenuar të drejtën e procesit të rregullt ligjor në aspektin e parimit të mbrojtjes, mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, parimit të barazisë së armëve dhe parimit të gjykimit kontradiktor.

Në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese ka juridiksion të shqyrtojë në mënyrë përfundimtare ankesat e individëve, të cilat kanë për objekt shkeljen e së drejtës së tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese, në praktikën e saj, ka vlerësuar si elemente thelbësorë të procesit të rregullt ligjor në procesin penal, të drejtën e mbrojtjes, barazinë e armëve, gjykimin kontradiktor, mosrëndimin e pozitës së të pandehurit, të cilët duhet të respektohen në të gjitha shkallët e gjykimit, duke përfshirë dhe atë në Gjykatën e Lartë (*shih vendimet nr.16, datë 8.6.2006; nr.13, datë 21.7.2008; nr.15, datë 22.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në lidhje me respektimin e së drejtës së mbrojtjes në Gjykatën e Lartë, Gjykata Kushtetuese është shprehur, se garantimi i një mbrojtjeje efektive dhe të dobishme në Gjykatën e Lartë bëhet e domosdoshme nga kompetenca e kësaj gjykate për të gjykuar çështjet vetëm për shkaqe ligjore. Në një proces penal, mbrojtja efektive është e nevojshme dhe ka lidhje të drejtpërdrejtë me parimin e kontradiktorialitetit, për të disponuar cilësisht mjete të barabarta.

Gjykata Kushtetuese standardin e së drejtës së mbrojtjes në Gjykatën e Lartë e ka zhvilluar në lidhje me praninë e mbrojtësit në gjykim. Është vlerësuar, se situata juridike, kur rekursi paraqitet nga i akuzuari, nuk është e njëjtë me rastin kur rekursi paraqitet nga prokurori. Gjykimi i zhvilluar pa praninë e të gjykuarit apo të mbrojtësit të tij, si rrjedhojë e një rekursi të ushtruar nga prokurori, mbart në vetvete mundësinë e përkeqësimit të pozitës së të pandehurit (*shih vendimet nr.23, datë 13.10.2005 dhe nr.13, datë 21.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese ka ritheksuar, se interesat e drejtësisë kërkojnë detyrimisht realizimin e mbrojtjes, qoftë edhe me avokat të caktuar kryesisht. Kjo mbrojtje bëhet akoma më e nevojshme kur i pandehuri gjykohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, në të cilin, ndër të tjera, kërkohet një rendim i pozitës së tij, krahasuar me vendimin e dhënë për këtë çështje nga gjykata e apelit (*shih vendimet nr.33, datë 24.11.2003; nr.23, datë 13.10.2005; nr.24, datë 26.10.2005; nr. 16, datë 8.6.2006; nr.13, datë 13.4.2007; nr.5, datë 4.3.2008; nr.13, datë 21.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

Çështja në shqyrtim vlerësohet e ngjashme me rastet e lartpërmendura, të cilat kanë krijuar një jurisprudencë të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, kur Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka zhvilluar gjykimin e iniciuar, me rekurs të prokurorit, pa praninë e të gjykuarit dhe të mbrojtësit të tij, me pjesëmarrjen vetëm të prokurorit.

Nga aktet e çështjes në shqyrtim rezulton, se gjykimi më datë 6.2.2008 nuk është zhvilluar dhe është shtyrë për mosparaqitje të mbrojtësit të të gjykuarit. Më pas, në datë 9.4.2008, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka zhvilluar gjykimin në mungesë të të gjykuarit dhe mbrojtësit të tij dhe, veprimet e vetme të kryera për lajmërimin kanë të bëjnë me komunikimin e rekursit të gjykuarit dhe mbrojtësit të tij (fq. 10-11 të dosjes gjyqësore).

Gjykata Kushtetuese vlerëson, se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk duhej të

zhvillonte gjykimin në mungesë të mbrojtësit të të gjykuarit, por duhej të ushtronte të gjithë mjetet procedurale për të garantuar praninë e mbrojtësit në gjykim, qoftë dhe duke e caktuar atë kryesisht. Vazhdimi i gjykimit të çështjes në mungesë (*in absentia*) të tij dhe të mbrojtësit i ka cenuar kërkuesit të drejtën e mbrojtjes, si një element i së drejtës për proces të rregullt ligjor, garantuar nga nenet 31 dhe 42 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ.

Ushtrimi i së drejtës së mbrojtjes, jo vetëm do t'i siguronte kërkuesit një mbrojtje efektive, por do t'i jepte mundësinë të gëzonte të gjitha garancitë e gjykimit të rregullt ligjor, të garantuara nga dispozitat e lartpërmendura. Po kështu, cenimi i së drejtës së mbrojtjes ka sjellë si pasojë dhe cenimin e së drejtës për *barazi të armëve* dhe së drejtës për *gjykim kontradiktor*.

Sa më lart, Gjykata Kushtetuese vlerëson, se në procesin e zhvilluar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë janë cenuar parime që qëndrojnë në themel të procesit të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese, në disa vendime të mëparshme, ka zhvilluar jurisprudencën e saj lidhur me të drejtën e të gjykuarit për t'u mbrojtur në procesin penal në Gjykatën e Lartë. Fuqia detyruese e vendimeve të mëparshme është e lidhur me çështjet konkrete të shqyrtuara, por dhe me interpretimin e bërë nga kjo Gjykatë në pjesën arsyetuese për të drejtën e mbrojtjes për fakte të njëjta kushtetuese. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme, sipas nenit 132, pika 1 të Kushtetutës. Ndikimi i vendimeve të Gjykatës është i tillë, që u imponon të gjitha organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj (*shih vendim nr.14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk mund ta zhvillojë gjykimin e iniciuar me rekurs të prokurorit, me pjesëmarrjen vetëm të këtij të fundit, pa praninë e të gjykuarit apo mbrojtësit të tij, qoftë dhe të caktuar kryesisht.

B. Lidhur me pretendimin për cenim të së drejtës së mosdënimit pa ligj

Kërkuesi ka parashtruar, se është dënuar për veprën penale të “prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal ndërkohë, që mbajtja e një sasi të vogël droge me qëllim përdorimi nuk është veprim i dënueshëm në kuptim të kësaj norme. Përmbajtja e normës nuk ka përcaktuar sasinë e drogës për përdorim vetjak dhe nuk e lidh këtë sasi me përdorimin ditor, por interpretimi i gabuar, bërë nga gjykata bazuar vetëm në kriterin e sasisë së drogës, ka cenuar të drejtën e tij të *mosdënimit pa ligj*.

E drejta e shtetasve për të mos u dënuar pa ligj, sanksionuar në nenin 29 të Kushtetutës dhe në nenin 7 të KEDNJ, është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Ky parim duhet të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar (*shih vendimin nr.14, datë 17.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

Garancia e nenit 7 të Konventës mishëron një parim të përgjithshëm sipas të cilit, çdo veprë penale duhet të parashikohet me ligj dhe individit duhet të jetë objektivisht në gjendje të kuptojë përmbajtjen e normës penale dhe, nëse është e nevojshme, me ndihmën e interpretimeve gjyqësore të saj, se çfarë veprimesh apo mosveprimesh do ta bëjnë atë përgjegjës penalisht. Kur bëhet fjalë për mundësinë e individit për të parashikuar pasojat e veprimeve të tij, nuk është e thënë që të nënkuptohet një qartësi absolute. Ligji duhet të jetë në gjendje të ndjekë rrethanat e ndryshme dhe, për këtë arsye, një standard i një parashikueshmërie të arsyeshme është i mjaftueshëm (*GJEDNJ kërkesa nr. 45771/99 Veeber kundër Estonisë 21 janar 2003*).

Në çështjen objekt shqyrtimi, rezulton se kërkuesi është gjykuar dhe deklaruar fajtor për veprën penale të “prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. Në këtë dispozitë, elementet e veprës penale dhe dënimi përkatës janë të përcaktuara në mënyrë të arsyeshme dhe të mjaftueshme, duke i dhënë mundësi kërkuesit të dijë, se cilat veprime apo mosveprime e bëjnë atë penalisht përgjegjës. Kjo dispozitë ka qenë e tillë që nga viti 2001, pra dhe në kohën e kryerjes së veprës penale.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka interpretuar elementet e veprës penale të “prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 të Kodit Penal, në përputhje me interpretimin e bërë kësaj norme nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin

nr.1, datë 27.3.2008, në të cilin është sqaruar përmbajtja e dispozitës dhe janë përcaktuar kufijtë e zbatimit të saj.

Për rrjedhojë pretendimi i kërkuesit se interpretimi i gabuar i nenit 283/1 KP ka sjellë dënimin e tij pa ligj, rezulton i pabazuar.

C. Lidhur me pretendimin për cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë

Kërkuesi ka pretenduar se interpretimi i gabuar i nenit 283/1 të KP ka cenuar dhe parimin e *prezumimit të pafajësisë*. Sipas tij, dyshimi nëse ai është ose jo përdorues droge nuk është vlerësuar në favor të tij, pasi gjykata është bazuar në përcaktimin e fajësisë nisur vetëm nga sasia e drogës së sekuestruar, duke kaluar kështu barrën e provës për vërtetimin e akuzës nga prokurori tek i pandehuri.

Gjykata Kushtetuese është shprehur se parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga nga elementet thelbësore të procesit të rregullt ligjor dhe garantohet nga neni 30 i Kushtetutës sipas të cilit, “Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë”. Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e ka interpretuar kuptimin e parimit të prezumimit të pafajësisë dhe ka përcaktuar aspektet e tij. Parimi i prezumimit të pafajësisë do të thotë që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte, të cilat duhet të provohen nga akuza (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 18.9.2008*).

Edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) është shprehur, se prezumimi i pafajësisë kërkon, ndër të tjera, që kryerja e detyrave nga anëtarët e një gjykate nuk duhet të fillojë me idenë e paracaktuar se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet, se barra e provës i takon prokurorit dhe çdo dyshim duhet të jetë në favor të të akuzuarit. Është detyrë e prokurorit ta informojë të akuzuarin për çështjen kundër tij, në mënyrë që ai të mund të përgatisë e paraqesë mbrojtjen, si dhe t'i kundërshtojë provat të cilat mjaftojnë për ta dënuar atë (*shih vendimet e GJEDNJ Minelli kundër Zvicrës; John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, 8 shkurt 1996; Telfner kundër Austrisë 20 qershor 2001*).

Nga shqyrtimi i këtij pretendimi nuk rezultojnë prova që të pasqyrojnë faktin se anëtarët e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që kanë gjykuar çështjen, e kanë konsideruar kërkuesin fajtor para se të shpallej vendimi për fajësinë e tij. Nga sa sipër, vlerësohet se gjykata nuk e ka filluar procesin gjyqësor me bindjen e paracaktuar se kërkuesi e ka kryer veprën penale. Gjithashtu, vlerësohen të pabazuara pretendimet e kërkuesit për kalim të barrës së provës nga prokurori tek i gjykuari, për mosvlerësim të dyshimeve në favor të tij apo për përcaktimin e fajësisë pa prova të provuara nga prokurori, pasi këto nuk gjejnë pasqyrim në aktet dhe materialet gjyqësore. Në këto rrethana vlerësohet se nuk është cenuar asnjë nga aspektet e parimit të prezumimit të pafajësisë.

Lidhur me pretendimi e kërkuesit, se interpretimi i gabuar i nenit 283/1 të KP ka cenuar parimin e *prezumimit të pafajësisë*, Gjykata vlerëson se mënyra e interpretimit të nenit 283/1 të Kodit Penal nuk është në juridiksion të Gjykatës Kushtetuese, sa kohë që nuk cenohet ndonjë aspekt i procesit të rregullt ligjor.

Rrjedhimisht, pretendimi i kërkuesit për cenim të parimit të *prezumimit të pafajësisë* është i pabazuar.

Si përfundim, Gjykata Kushtetuese vlerëson, se në procesin e zhvilluar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është cenuar e drejta e kërkuesit për mbrojtje në procesin penal, që është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ.

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr.181, datë 9.4.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vladimir Kristo (kryetar), Sokol Sadushi, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Vitore Tusha, Sokol Berberi